



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 17 pika b të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës të Kosovës" nr 28/2008), të nenit 13 dhe nenit 15 të Ligjit nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor, nenit 11 të Ligjit nr. 03/L - 106, për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, nenit 15, paragrafi 15.1, pika b dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 12.07.2012, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES URBAN
TË LAGJES "MATI 2"

Neni 1.

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues urban të lagjes "Mati 2" në Prishtinë.

Neni 2.

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues urban sipas këtij vendimi, është rregullimi dhe urbanizimi i hapësirës brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, sipas destinimeve të planifikuara me Plan strategjik - zhvillimor urban i Prishtinës 01 nr. 031 - 1231/1, të dt. 02.07.2004 dhe normave dhe standardeve tjera të parapara me ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.

Neni 3.

1. Me planin rregullues nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e përfshirë në kuadër të Planit strategjik - zhvillimor urban i Prishtinës, e cila është e emëruar si "Mati 2" dhe përkufizohet: në anën lindore me kufirin e planit rregullues "Mati 3", në anën jugore me kufirin e zonës së Prishtinës së Re - zona lindje, në anën perëndimore me kufirin e Planit rregullues "Mati 1", dhe në anën veriore me Unazën e brendshme, e cila ka një sipërfaqe rreth 180 ha.
2. Kufijtë e përshkruar të hapësirës nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4.

1. Bartës i hartimit të detyrave programore për hartim të këtij Plani rregullues është Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.
2. Hartimi i Planit rregullues, sipas këtij vendimi, do t'i besohet kompanisë profesionale, sipas procedurave të parapara ligjore.
3. Drejtoritë tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës janë të obliguara që të sigurojnë shënimet e nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij vendimi.

Neni 5.

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij vendimi , janë të siguruara nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6.

Plani rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet procedurës së diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Neni 7.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Drejtoritë tjera të Komunës do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuar për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 8.

Ky Vendim hyn në fuqi 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljes dhe ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. Nr. 035-25398 dt. 12.07.2012

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti , ecc i dipl.